



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.7808/2025

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e nëntë -IX- të rregullt për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 25.09.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Buxheti i komunës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2027-2028.
3. Kërkesë për rritjen e buxhetit të Komunës Hani i Elezit nga tejkalimi i projeksionit të të hyrave vetanake për vitin 2025.
4. Propozim vendim për planin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2026.
5. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2025/2026.
6. Propozim vendim për ryshqyrtim të aktit normativ.
7. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e buxhetit të komunës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2027-2028.
- Materialin e kërkesë për rritjen e buxhetit të Komunës Hani i Elezit nga tejkalimi i projeksionit të të hyrave vetanake për vitin 2025
- Materialin e propozim vendimit për planin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2026.
- Materialin e informatës mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2025/2026.
- Materialin e propozim vendim për ryshqyrtim të aktit normativ.

Hani i Elezit
Data:-17.09.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7809 /2025
Data: 17.09.2025

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e tetë -VIII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 21.08.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetarë i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2025.
3. Miratimi i Planit Zhvillimorë Komunal.
4. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2024-2025.
5. Informatë për korrje shirjet.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:- propozoj që në rend të punës të hynë edhe një pikë Planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. Arsyeja se po kërkoj që të hynë si pikë e rendit të punës është sepse dje na është dërguar nga Ministria përkatëse që me u proceduar për miratim në kuvend të komunës.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës nëse nuk ka propozimin që në rend të punës të hynë si pikë plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri,

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2025.
3. Miratimi i Planit Zhvillimorë Komunal.
4. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2024-2025.
5. Informatë për korrje shirjet.
6. Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- raporti i gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 paraqet pasqyrën e punës së institucioneve komunale në shërbim të qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit. Kjo periudhë është karakterizuar nga përpjekje të vazhdueshme për të ruajtur ritmin e zhvillimit, për të rritur efikasitetin e administratës dhe për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme për sfidat me të cilat përballemi si komunitet. Në këtë gjashtëmujor kemi thelluar përkushtimin tonë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe asaj publike, investime në arsim dhe shëndetësi, përkrahjen e familjeve në nevojë, dhe përfshirjen e të rinjve në jetën publike. Janë realizuar projekte në fshatra dhe në qytet që ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve tanë. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar planifikimit të projekteve të reja kapitale përmes bashkëpunimit me nivelin qendror dhe partnerët zhvillimorë, si dhe përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për thithjen e fondeve nga burime të ndryshme, përfshirë fondet IPA dhe mbështetjen apo bashkëfinancimet me nivelin qendror apo organizata dhe donatorë të ndryshëm. Po ashtu, kemi avancuar proceset e digjitalizimit dhe kemi rritur qasjen e qytetarëve në shërbimet komunale përmes kanaleve të hapura të komunikimit, konsultimeve publike dhe përfshirjes aktive të grupeve të ndryshme të interesit. Një aspekt i rëndësishëm i këtij gjashtëmujori kanë qenë takimet zyrtare dhe konsultimet me qytetarë dhe me institucione vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, të cilat kanë kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe kanë krijuar mundësi për përkrahje konkrete në fusha kyçe. Për mos me hy në detale në raport i keni të shënuara në mënyrë të detajuar. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- prej IPA fondeve a është marr diçka a shihet që do të punohet .

Mehmet Ballazhi thekson:-është punuar dhe në fund të muajit mars të vitit vijues do të përfundon si projekt dhe ne kemi arritur me implementuar shumicën e projektit sipas planifikimeve, janë vendosur kamerat për monitorim, disa pajisje tjera që i shërbejnë qëllimit të këtij projekti për vlerësimin e hershëm të vlerësimeve nga lumi Lepenc, kamioni për transportin e mbeturinave, është në proces një kamionë i vogël dhe një automjet tjetër të cilët janë në proces të përfundimit të këtij projekti. Fillimisht ka qenë një vonesë për shkak burokracisë administrative për të cilën nuk dua me hyjë në atë pjesë , mirëpo kemi shkuar mirë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

3. Miratimi i Planit Zhvillimorë Komunal.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:-siç jeni në dioni ne kemi përfunduar procesin e hartimit të planit zhvillimorë, pra të gjitha planet tjera komunale duhet të jenë në pajtim me planin zhvillimorë, njësojë sikurse plani zhvillimorë duhet të jetë në pajtim me planin hapësinorë të Kosovës . Për ndryshe plani zhvillimorë komunal është një plan strategjikë shumë sektorial i cili përcakton zhvillimet afat gjata të zhvillimit ekonomik social dhe hapësinorë të komunës. Hartimi i këtij dokumenti është bërë në pajtim me ligjin Hapësinorë dhe të gjitha udhëzimeve tjera administrative, rregulloreve, strategjisë kombëtare . Ky dokument i ka kaluar të gjitha filtrat e mundshme dhe fillimisht është prezantuar para komisionit për zhvillimin e planeve komunale në kuadër të Ministrisë së Planifikimit Hapësinorë . Me datë 26.02.2025 është dhënë pëlqimi nga Ministria e Mjedisit për hapjen e debatit publik dhe në mbledhje të kuvendit të muajit mars është marr vendim për hapjen e debatit publik . Debatit publik përfshinë shqyrtimin kryesorë publik nga data pesëmbëdhjetë prill deri me pesëmbëdhjetë maj, ndërsa me datë katërmëdhjetë prill Kryetari i Komunës ka formuar një grup punues për shqyrtimin e kërkesave, vërejtjeve, komenteve dhe propozimeve të cilat kanë rrjedhë nga debati publik . Pas përfundimit të debatit publik në afatin e paraparë prej një muaj është hartuar raporti i shqyrtimit publik i planit zhvillimorë kështu që dokumenti i kërkuar i është dorëzuar Ministrisë së Mjedisit për miratim final. Me datën tredhjet e një gusht Ministria e Mjedisit ka dhënë pëlqim për miratimin e Planit Zhvillimorë Komunal por tani radhën e keni ju që ta miratoni këtë dokument. Për ndryshe Plani Zhvillimorë nuk është dokument politik as partiak por në hartimin e këtij dokumenti kanë marr pjesë zyrtarë të komunës, drejtorët komunal Kryetari dhe Nënkryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, përfaqësues të partive politike, këshilltarë dhe po ashtu edhe ekspertë të jashtëm. Me që Ministria për Planifikim Hapësinorë ka dhënë pëlqim për miratimin e këtij dokumenti pra do të thotë se dokumenti i plotëson të gjitha kushtet ligjore kërkoj nga ju që pas diskutimeve dhe sugjerimeve ta miratoni Planin Zhvillimorë Komunal.

Zaim Bela thekson:- a është bërë ndonjë ndryshim sa i përket ndërtimeve në zonat urbane dhe në zonat rurale për shkak se edhe në të kaluarën kemi pasur probleme sa i përket ndërtimeve jashtë zonave ndërtimore . A është bërë zgjerimi i zonave ndërtimore dhe sa katëshe munden me u ndërtuar në Han të Elezit dhe sa në zonat rurale.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket ndërtimeve nëpër të gjitha fshatrat i kemi zgjeruar kufijtë e vendbanimeve dhe afati i Planit Zhvillimorë është për tetë vite dhe po besojë që nuk duhet me pasur problem sa i përket ndërtimeve. Çështja e ndërtimeve të etazhitetit nuk përcaktohet me planin zhvillimorë komunal por këto përcaktohen me hartën zonale.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU PLANI ZHVILLIMORË KOMUNAL

4. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2024-2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- materialin e keni pranuar me kohë, është përgatitur në mënyrë të detajuar dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Nora Xhoni thekson:- na është dërguar për me aplikuar për librat për nxënësit por librat të cilat u janë dhënë në përfundim të mësimi, çka do të bëhet me ato libra a duhet të kthehen pasi e kanë bërë me aplikuar.

Hisni Luri thekson:- për librat nga klasa 1-5 dhe 6-9 Ministria do ti subvencionon të gjithë prindërit por për klasën 6-9 e kanë targetuar për materialet shkollore.

Kryesuesi thekson:- është mirë që librat të cilat i marrin nxënësit me u caktuar një pikë këtu në Han të Elezit në mënyrë që mos me shkuar në Kaçanik apo më larg.

Hisni Luri thekson:- edhe viteve të tjera jemi munduar me bërë kështu por për shkak se libraritë dhe dyqanet të cilat i furnizojnë me materiale shkollore për librat të cilat mund ti blejnë paguaj TVSH, kështu që për këta nuk është e leverdishme por i kemi orientuar prindërit që në mënyrë onllajn ti porosisin ato libra.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

5. Informatë për korrje shirjet.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- edhe në këtë vit procesi i korrje shirjeve është zhvilluar normalisht sikur viteve të tjera dhe nuk ka diçka dallim. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:-pasi është rritur numri i fermerëve të cilët po mbjellin grurë a ka mundësi me ua kryer pagesën e korrje shirjeve.

Abduraman Bushi thekson:- në këtë vit do të fillojmë por jo plotësisht po do të mundohemi që njëqind euro për hektarë me ua paguar për arsye se procesi i korrje shirjeve nuk është i përfshirë në pagesat direkte.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6.Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:-nuk kam diçka për me shtuar më shumë, është i njëjti plan siç ka qenë më herët, nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI NDËR KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE PËR RAJONIN E GJILANIT DHE FERIZAJIT

7.Të ndryshme.


Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:38.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

Florim Shkreta





REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT

Nr. 04/7008/2025

DATA :	28.08.2025
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtore për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Projekt Buxheti për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2027-2028

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar/a Anëtarë/e të Kuvendit Komunal,

Me anë të kësaj shkrese, ju dërgojmë Projekt Buxhetin për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2027-2028 për Komunën e Hanit të Elezit – 659.

Pjesë e Projekt Buxhetit 2026-2028 janë, si vijon:

1. Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve 2026-2028,
2. Tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale 2026-2028,
3. Tabela 4.3 Plani Afatmesëm i Të Hyrave totale të Buxhetit Komunal 2026-2028,
4. Tabela e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIK O F KOSOVO

KOMUNA – MUNICIPALITY

HANI I ELEZIT



04/7008/2025

Data:28/08/2025

PROJEKT BUXHETI PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2027-2028

Hani i Elezit, 2025

Hyrje

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit është një plan fiskal që përcakton të hyrat dhe shpenzimet e parashikuara për të udhëhequr shërbimet dhe politikat që zbatohen gjatë vitit fiskal 2026. Ai përcakton bazat për ato që do të jenë qëllimet dhe arritjet e komunitetit tonë.

Buxheti i propozuar do të vazhdojë të arrijë prioritetet afatmesme të komunës siç janë aprovuar në Qershor 2025 me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Ju do të shihni se këtyre prioritetëve do t'i referohem përgjatë këtij dokumenti. Për më tepër, buxheti i propozuar reflekton kryesisht kërkesat e qytetarëve/eve, siç paraqiten gjatë dëgjimeve publike buxhetore, të organizuara nga ekzekutivi dhe legjislativi komunal.

Buxheti i vitit 2026 pasqyron përpjekjen tonë të vazhdueshme për të ofruar shërbime arsimore cilësore në nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm; shërbime shëndetësore, si dhe zhvillim të mëtutjeshëm të infrastrukturës që do të japë kontribut drejt zhvillimit të komunës së Hanit të Elezit.

Për t'i zbatuar prioritetet e mësipërme, buxheti për vitin fiskal 2026 ka përfshirë gamën e plotë të operacioneve dhe programeve komunale të cilat i përfshijnë të mëposhtmet:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Administrata dhe Personeli,
3. Zyra e Kuvendit Komunal,
4. Buxheti dhe Financat,
5. Shërbimet Publike, Emergjencia dhe Mbrojtja Civile,
6. Zyra për Komunitete dhe Kthim,
7. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural,
8. Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi,
9. Planifikimi Urban dhe Inspeksioni,
10. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale,
11. Arsimi dhe Shkenca dhe
12. Kultura, Rinia dhe Sporti.

Programet e komunës vazhdojnë ta pasqyrojnë qëllimin tonë për ta përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve/eve tanë/tona, shoqëruar me një menaxhim të shëndoshë dhe financiar.


Ky buxhet i mundëson komunës t'i mbajë të qëndrueshme shpenzimet dhe të financojë iniciativa dhe projekte të rëndësishme ku i keni të paraqitura më poshtë në tabelën e Investimeve Kapitale Komunale 2026-2028.

Të hyrat buxhetore

Buxheti Komunal për vitin 2026 mbështetet me 91.6% në transferet nga Qeveria Qëndrore në formën e Granteve Qeveritare, ndërsa shuma e mbetur krijohet nga burimet e të Hyrave Vetanake. Grantet totale nga Qeveria të propozuara për vitin 2026 janë 3,877,962.00 €, ndërsa 356,720.00 € apo 8.4 % paraqesin burimet nga të Hyrat Vetanake.

Shuma e granteve të transferuara në Komunë, duke përfshirë Grantin e Përgjithshëm, Grantin Specifik të Arsimit dhe Grantin Specifik të Shëndetësisë, llogariten në bazë të një formule shtetërore, e cila merr parasysh numrin e nxënësve/eve, numrin e shkollave, mësimdhënësve/eve (për Grantin e Arsimit), madhësinë e Komunës, numrin e popullsisë (për Grantin e Përgjithshëm dhe atë të Shëndetësisë).

Një ndarje nga financimi Qeveritar dhe nga Hyrat Vetanake të buxhetuara është paraqitur në grafikun vijues:



Plani i të Hyrave Vetanake për vitin 2026 sipas llojit të të hyrave

Të hyrat buxhetore Komunale realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores për Taksa Komunale, Rregullorës së Tatimit në Pronën e Paluajtshme si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna është e autorizuar dhe ka të drejtë t'i inkasoj.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në Pronë dhe në Tokë, si gjenerator kryesor i të hyrave vetanake komunale (THVK), e që këtë lloj të hyre komuna pas grumbullimit duhet ekskluzivisht të shpenzoj vetëm për qëllime të realizimit të projekteve kapitale si, në infrastrukturë rrugore, në ujësjellës, kanalizime dhe investime e tjera, thënë ndryshe këto mjete pas inkasimit menjëherë i'u rikthehen qytetarëve/eve apo tatimpaguesëve/eve përmes formës së investimeve të destinuara për ngritjen e infrastrukturës komunale dhe mirëqenies sociale.


Të hyrat e komunës përbëhen kryesisht nga këto lloje të të hyrave:

- Tatimi në pronë;
- Tatimi në tokë;
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë biznesore;
- Taksat për leje të ndërtimit;
- Taksa për shfrytëzimin e pronës komunale;
- Taksa për regjistrimin e automjeteve motorike;
- Taksat administrative komunale (taksa për dokumentacionin lidhur me statusin shoqëror si certifikatat e lindjes, martesës, vdekjes, shtetësisë etj);
- Bashkë-pagesat në arsim;
- Bashkë-pagesat në shëndetësi dhe
- Të hyra tjera.

Plani i të hyrave për tatimin në pronë dhe tokë llogaritet në faturën vjetore Komunale, dhe bazohet në vlerën e pronës/tokës shumëzuar me normën tatimore, si dhe supozimin se Komuna do të vazhdojë përpjekjet për arkëtimin e borxheve të vjetra.

Tarifat dhe taksat e tjera përcaktohen në bazë të një rregulloreje komunale, dhe në parim përcaktohen për aq sa kostoja e tyre të rikupërohet.

Paraqitja Grafike e Projeksionit të të Hyrave Komunale për vitin 2026




Shpenzimet

Kostoja e personelit apo kategoria e pagave dhe shtesave paraqesin shpenzimin më të madh të buxhetit komunal (rreth 59.16 % buxhetit të përgjithshëm komunal) dhe qasja për caktimin e kësaj shume është sipas formulës.

Kostot operative ose të mirëmbajtjes dhe ato operationale të Komunës siç janë: mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale dhe subvencionet përfaqësojnë me rreth 20.47% të buxhetit. Rreth 20.37% të buxhetit të përgjithshëm paraqesin shpenzimet kapitale të shoqëruara me investimet në Arsim, Shëndetësi, Shërbime Publike, Administratë të Përgjithshme dhe Planifikim Urban.

Buxheti i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike në total (4,234,682.00 EUR)



Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2026:

- Pagat dhe shtesat 2,505,202.00 € apo 59.16 %
- Mallrat dhe shërbimet 571,000.00 € apo 13.48 %
- Shpenzimet komunale 111,000.00 € apo 2.62 %
- Subvencionet dhe transferet 185,000.00 € apo 4.37 %
- Shpenzimet kapitale 862,480.00 € apo 20.37 %
- Totali 4,234,682.00 € apo 100%

Procesi dhe parimet e buxhetit

Çdo vit, Komuna përgatit një buxhet vjetor që llogarit të ardhurat që vijnë nga Grantet e Qeverisë Qëndrore, tatimet lokale dhe tarifatat, si dhe burimet e tjera dhe përcakton një plan për mënyrën se si Komuna synon t'i shfrytëzojë ato burime gjatë vitit pasues kalendarik.

Në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Komuna përgatit një buxhet të ekuilibruar, që do të thotë se shpenzimet e përvetësuara nuk e tejkalojnë shumën e burimeve që ajo e vlerëson se do të jenë në dispozicion për atë vit.

Procesi i buxhetimit fillon çdo pranverë (maj) kur komuna e pranon Qarkoren Buxhetore 01 të Ministrisë së Financave, e cila përcakton nivelin dhe burimet e ndara për komunën dhe pragon indikativ për mbledhjen e të hyrave vetanake komunale. Sipas saj Komuna e miraton Kornizën Buxhetore Afatmesme e cila paraqet planin buxhetor për vitin e ardhshëm dhe parashikimin për dy vite dhe shërben si pikënisje për përgatitjen e buxhetit të vitit të ardhshëm. Dokumenti përfshin një analizë historike të të hyrave dhe shpenzimeve të Komunës, parashikimin e kornizës financiare për të hyrat e komunës dhe analiza më të hollësishme të projekteve kapitale të Komunës, dhe aprovohet nga Kuvendi Komunal më së largu deri më 30 qershor.

Gjatë muajëve korrik-gusht, Departamentet Komunale dhe Departamenti i Buxhetit dhe Financave i Komunës vazhdojnë procesin e hartimit të buxheteve të hollësishme të departamenteve. Së pari, departamentet e tjera komunale e informojnë Departamentin e Buxhetit dhe Financave për nevojat për personel dhe nevojat e tjera për vitin e ardhshëm. Departamentet e mbështesin buxhetin e tyre kryesisht në të dhëna historike dhe inkurajohen që të mendojnë në mënyrë strategjike me qëllim të ofrimit të shërbimeve me cilësi të lartë duke ulur kostot e parëndësishme. Departamentet i hartojnë kërkesat e tyre buxhetore bazuar në një model specifik dhe i paraqesin të njëjtat në Departamentin e Buxhetit dhe Financave, si dhe Kryetarit të Komunës. Buxheti i propozuar, është në dispozicion për rishikim publik gjatë seancave dëgjimore të buxhetit për qytetarët/et. Departamentet komunale i përfundojnë buxhetet e tyre pasi të vijë Qarkorja 02 e buxhetit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në fillim të gushtit, me limite të forta se sa duhet të shpenzojë komuna për të pesë kategoritë në vijim: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere si dhe investime kapitale.

Departamenti i Buxhetit dhe Financave i Komunës i rishikon hollësisht nevojat operative dhe programatike të secilit departament dhe vlerëson shumën e të hyrave që komuna do ta mbledhë gjatë vitit të ardhshëm, përveç Granteve të Qeverisë Qëndrore që do t'i marrë. Në fund të gushtit / fillimit të shtatorit, Zyra e Kryetarit dhe Departamenti i Buxhetit dhe Financave punojnë me departamentet e tjera për ta hartuar një propozim përfundimtar të buxhetit. Propozimi për buxhetin e Komunës prezantohet dhe miratohet në Asamblenë Komunale para datës 30 Shtator. Buxheti komunal më pas dorëzohet në Ministrinë e Financave dhe konsolidohet në Buxhetin e Kosovës dhe miratohet nga Parlamenti i Kosovës çdo Dhjetor, dhe bëhet Ligj. Ligji për Buxhetin e Kosovës zbatohet më 1 janar dhe po ashtu paraqet buxhetin operativ komunal për atë vit.

Kalendari buxhetor

Prill-Maj

- Komuna e pranon Qarkoren e Buxhetit 01 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e cila parashikon financimin e burimeve të komunës, udhëzimet fillestare dhe kalendarin tregues të afatit kohor.
- Departamentet e Komunës, bazuar në Qarkoren 01, i përgatisin planet e tyre të Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB) për tre vitet e ardhshme.
- Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Departamenti i Buxhetit dhe Financave në diskutim me departamentet e tjera vendosin për propozimin e KAB-it në Kuvendin Komunal.

Qershor

- Asambleja Komunale rishikon dhe miraton Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës.

Gusht

- Fillon përgatitja e Buxhetit Vjetor Komunal të detajuar në bazë të Qarkores 02.
- Departamenti i Buxhetit dhe Financave të Komunës bashkë me Departamentet e tjera vazhdojnë procesin e hartimit të buxheteve të detajuara duke u bazuar në një model të sugjeruar për përgatitje të kërkesave buxhetore.

- Projekt-buxheti vihet në dispozicion të publikut për rishikim gjatë seancave dëgjimore/dëgjimeve publike të buxhetit.
- Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Departamenti i Buxhetit dhe Financave punojnë me departamentet e tjera për të zhvilluar një propozim buxhet përfundimtar.

Shtator

- Asambleja Komunale diskuton dhe miraton buxhetin e propozuar.
- Buxheti i aprovuar i dërgohet Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Dhjetor

- Buxheti komunal konsolidohet në Buxhetin e Kosovës dhe miratohet nga Parlamenti.

Janar

- Zbatohet Ligji për Buxhetin e Kosovës dhe ku përfshihet buxheti operativ komunal për vitin.

Gjatë tërë vitit

- Departamenti i Buxhetit dhe Financave administron burimet e alokuara me Ligjin e Buxhetit dhe rregullisht rishikon të hyrat, shpenzimet, dhe çdo prirje apo ngjarje që mund të ndikojë në financat e Komunës.
- Në baza të vazhdueshme, departamentet komunale japin informacione mbi performancën e programeve për të siguruar që burimet e Komunës përdoren në një mënyrë që të maksimizojë vlerën e tatimpaguesit dhe të sigurojë shërbime me cilësi më të lartë.

Dokumentet e buxhetit

Buxheti i Komunës hartohet duke u bazuar në politikat dhe dokumentet fiskale të mëposhtme, të hartuara në nivelin Qeveritar nacional dhe komunal. Meqenëse të gjitha buxhetet komunale konsolidohen në buxhetin e Kosovës, si bazë për zhvillimin e buxhetit të Komunës, duke pasqyruar të hyrat, shpenzimet dhe planin e përgjithshëm financiar për vitin e ardhshëm, janë dokumentet më poshtë:

KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE (KASH) 2026-2028

KASH-i është një dokument që hartohet çdo vit, duke përfshirë planifikimin e shpenzimeve për periudhën trevjeçare. Ai përcakton prioritetet afatmesme të shpenzimeve dhe kufizimet buxhetore karshi të cilave hartohen dhe rafinohen planet sektoriale. KASH-i siguron bazën për planifikimin vjetor të buxhetit, në nivel nacional dhe komunal, kur ai të miratohet nga Qeveria e Kosovës.

QARKORET BUXHETORE

Çdo vit, sipas kalendarit buxhetor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve lëshon deri në 3 Qarkore për përgatitjen dhe prezantimin e propozimeve për vitin e ardhshëm buxhetor. Qarkoret buxhetore dorëzohen në institucionet e nivelit qendror, si dhe komunat, në mënyrë që të udhëzojnë përgatitjen e buxhetit. Procesi i vërtetë i buxhetit si në organizata buxhetore qendrore, ashtu edhe në komunë, fillon kur MF dërgon qarkoren e parë.

PLANI ZHVILLIMOR DHE URBANISTIK I KOMUNËS 2025-2033

Ky është një proces dhe plan teknik që lidhet me zhvillimin dhe dizajnin e shfrytëzimit të tokës dhe mjedisit ndërtimor në komunën e Hanit të Elezit. Edhe pse ky dokument është në proces të hartimit, prapë mbetet bazë kryesore për Departamentin e Urbanizmit që të përdoret për procesin e tyre të planifikimit vjetor dhe planifikimit buxhetor.

KORNIZA AFATMESME E BUXHETIT KOMUNAL (KAB Komunale) 2026-2028

Pas pranimit të Qarkores Buxhetore nga MF, dokumenti KAB përgatitet çdo vit, në mënyrë që buxheti të vendoset në një perspektivë afatmesme. Asambleja Komunale miraton këtë dokument çdo vit para 30 qershorit. KAB-i Komunal mbulon përgatitjen, ekzekutimin dhe monitorimin e planit buxhetor shumëvjeçar të Komunës dhe përmban parashikimet e shpenzimeve dhe të hyrave.

RREGULLORJA E TAKSAVE KOMUNALE

Komuna miraton rregullore mbi ngarkesat, taksat dhe tarifat e përdoruesve, në bazë vjetore. Kjo rregullore përcakton ngarkesën e komunës dhe paraqet një tregues të rëndësishëm për të përcaktuar të hyrat vetanake komunale.

LISTA E PROPOZUAR E PROJEKTEVE KAPITALE SIÇ PRANOHEN NGA QYTETARËT

Çdo verë, komuna mban dëgjime buxhetore me publikun dhe si rezultat i kësaj zhvillohet një listë e projekteve, sipas kërkesave të ndryshme. Shumica e kërkesave kanë të bëjnë me projekte kapitale

të vogla dhe të mëdha. Komuna i përfshin shumicën e kërkesave të pranura në planin vjetor të buxhetit komunal.

BUXHETI I PROPOZUAR KOMUNAL

Buxheti komunal është projekti i planifikuar i operimit financiar të komunës për vitin fiskal. Në përgjithësi, një buxhet llogarit të hyrat e pritura dhe shpërndan burimet për shpenzime të veçanta sipas prioriteteve dhe veprimeve të paracaktuara për zbatim.

Baza e buxhetimit

Komuna përgatit dhe prezanton buxhetin e saj vjetor sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Një buxhet i parave të gatshme detajon të ardhurat dhe shpenzimet e parave gjatë një periudhe të caktuar buxheti, në këtë rast gjatë një viti.

Plani i ndarjeve buxhetore për vitet 2026-2028

Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe shtesat	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total 2026	Total 2027	Total 2028
Zyra e Kryetarit	12	127,791.00	35,000.00	0	40,000.00	0	190,500.00	211,693.00	211,791.00
Zyra e Kuvendit Komunal	15	133,323.00	17,000.00	0	0	0	147,050.00	149,382.00	149,454.00
Administrata dhe Personeli	15	121,049.00	85,000.00	57,000.00	0	0	259,450.00	239,369.00	246,369.00
Buxheti dhe Financat	8	76,689.00	4,000.00	0	0	0	75,500.00	82,068.00	81,418.00
Shërbimet Publike dhe Emergjenca	10	90,038.00	110,000.00	4,000.00	15,000.00	145,000.00	362,479.00	417,787.00	480,987.00
Zyra Komunale për Komunitete	1	8,239.00	500	0	0	0	8,750.00	8,661.00	8,751.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	2	15,616.00	4,000.00	0	30,000.00	0	49,250.00	53,417.00	53,497.00
Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi	4	39,842.00	9,000.00	0	25,000.00	177,000.00	247,850.00	253,602.00	153,707.00
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	8	82,283.00	20,000.00	0	0	425,480.00	525,710.00	558,852.00	776,918.00
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	49	435,266.00	110,881.00	11,000.00	0.00	30,000.00	591,887.00	549,877.00	562,977.00
Administrata e shëndetësisë	2	14,416.00	500	0	0	0	15,750.00	16,116.00	16,416.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	47	420,850.00	110,381.00	11,000.00	0	30,000.00	576,137.00	533,761.00	546,561.00
Shërbimet sociale	3	28,810.00	2,500.00	3,000.00	0	0	33,749.00	34,360.00	35,120.00
Kultura, Rinia dhe Sportet	6	39,962.00	23,000.00	15,000.00	35,000.00	30,000.00	139,216.00	152,297.00	162,021.00
Arsimi dhe Shkenca	147	1,306,294.00	150,119.00	21,000.00	40,000.00	55,000.00	1,603,291.00	1,745,771.00	1,749,481.00
Administrata e arsimit	3	34,000.00	60,000.00	0	40,000.00	55,000.00	187,280.00	303,910.00	304,020.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	13	109,494.00	16,619.00	8,000.00	0	0	130,633.00	131,663.00	135,963.00
Arsimi fillor	109	959,602.00	66,500.00	9,500.00	0	0	1,061,310.00	1,084,196.00	1,083,196.00
Arsimi i mesëm	22	203,198.00	7,000.00	3,500.00	0	0	224,068.00	226,002.00	226,302.00
TOTALI	280	2,505,202.00	571,000.00	111,000.00	185,000.00	862,480.00	4,234,682.00	4,457,136.00	4,672,491.00

Financimi i investimeve kapitale komunale 2026-2028

Nr	Përshkrimi	Planifikimi 2026	Vlerësimi 2027	Vlerësimi 2028	Shpenzime totale 2026- 2028
	Hani i Elezit - 659	862,480.00	1,051,408.00	1,254,174.00	3,168,062.00
	SHPENZIMET KAPITALE TOTALE	862,480.00	1,051,408.00	1,254,174.00	3,168,062.00
180	Shërbimet publike dhe emergjenca	145,000.00	190,000.00	250,000.00	585,000.00
18444	Parandalimi dhe inspektimi i zjarreve	145,000.00	190,000.00	250,000.00	585,000.00
1	Ndërtimi i rrjetit elektrik nëntokësor në zonën urbane të Hanit të Elezit (Rr.Dëshmorët e Kombit, Rr.Xhemsedin Suma, Rr.Nuri Bushi, Rr.Imri Curri)	20,000.00	30,000.00	40,000.00	90,000.00
2	Ndriçimi publik në fshatrat: Pustenik, Dimcë, Gorancë, Krivenik, Seçishtë, Rezhancë, Paldenicë, Dermjak	20,000.00	20,000.00	35,000.00	75,000.00
3	Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit në Rr. Isa Berisha dhe zonat rurale në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Krivenik, Dimcë	20,000.00	25,000.00	40,000.00	85,000.00
4	Riparimi i rrugëve dhe trotuareve në Han të Elezit dhe në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Rezhancë, Krivenik	20,000.00	20,000.00	30,000.00	70,000.00
5	Shtimi i kapaciteteve të ujit në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit	25,000.00	30,000.00	35,000.00	90,000.00
6	Ndërtimi (ngritja e deponisë) për mbetje të ngurta (inerte)	15,000.00	20,000.00	25,000.00	60,000.00
7	Rregullimi i krojeve publike në Han të Elezit dhe në fshatrat: Dromjak, Seçishtë, Krivenik, Dimcë, Paldenicë, Pustenik dhe Rezhancë	10,000.00	25,000.00	20,000.00	55,000.00
8	Rregullimi i prrockave dhe kanalizimeve atmosferike në fshatrat: Paldenicë, Rezhancë dhe Seçishtë	15,000.00	20,000.00	25,000.00	60,000.00
480	Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik	177,000.00	180,000.00	80,000.00	437,000.00
48035	Zhvillimi Ekonomik	177,000.00	180,000.00	80,000.00	437,000.00
9	Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë	120,000.00	95,000.00	60,000.00	275,000.00
10	Rregullimi i shtigeve për ecje përreth projit Dimcë-Dermjak	25,000.00	25,000.00	-	50,000.00

11	Ndërtimi i tregut ditor në Han të Elezit	32,000.00	10,000.00	10,000.00	52,000.00
12	Rregullimi i sheshit të qytetit në Han të Elezit	-	50,000.00	10,000.00	60,000.00
660	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	425,480.00	456,408.00	674,174.00	1,556,062.00
66480	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni	425,480.00	456,408.00	674,174.00	1,556,062.00
13	Mjete të lira për bashkëinvestime	10,000.00	30,000.00	35,000.00	75,000.00
14	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe në fshatrat: Paldenicë, Dermjak, Pusteni, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë	50,000.00	55,000.00	60,000.00	165,000.00
15	Ndërtimi i mbikalimeve në Rr. Martirët Bushi dhe Rr. Lepenci	-	50,000.00	60,000.00	110,000.00
16	Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në Han të Elezit në Rr. Adem Jashari, Udhë e Shkronjave, Driton Loku, Paldenicë	25,000.00	30,000.00	39,174.00	94,174.00
17	Asfaltimi i rrugës transit në fshatin Gorancë	-	50,000.00	150,000.00	200,000.00
18	Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pusteni, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik	70,000.00	65,000.00	65,000.00	200,000.00
19	Ndërtimi (Rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pusteni, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik	60,000.00	53,000.00	60,000.00	173,000.00
20	Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimcës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri - Oborri i Komunës, Stadiumi i qytetit - Suad Brava - Shpronësim	80,000.00	20,000.00	15,000.00	115,000.00
21	Vendosja e ekranit për prezantimin e rezultateve të ndotjes së ajrit në rrugën Nuri Bushi	-	50,000.00	-	50,000.00
22	Rregullimi i hapësirave publike (me kubëza betoni dhe gjelbërim) në rr. Dëshmorët e Kombit, Isa Berisha në Han të Elezit dhe rr. Gafurr Loku fsh. Paldenicë	20,000.00	10,000.00	25,000.00	55,000.00
23	Ndërtimi i rrugës Nënberg në fshatin Seçishtë	20,000.00	13,408.00	15,000.00	48,408.00
24	Ndërtimi (shtrimi me zhavor) i rrugës në Seçishtë kah Vorbat	30,000.00	10,000.00	20,000.00	60,000.00
25	Ndërtimi i rrugës Hani i Elezit - Dimcë	-	-	60,000.00	60,000.00
26	Rregullimi i rrugës Fujza - Vërtomicë	15,480.00	10,000.00	60,000.00	85,480.00

27	Shtrimi me zhavor i rrugës prej burimit të fshatit Seçishtë deri te Lloka	20,000.00	10,000.00	10,000.00	40,000.00
28	Shtrimi me kubëza betoni i rrugës që lidh fshatin Rezhançë me varrezat	25,000.00	-	-	25,000.00
730	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	30,000.00	15,000.00	25,000.00	70,000.00
75050	Shërbimet e shëndetësisë primare	30,000.00	15,000.00	25,000.00	70,000.00
29	Rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së në Han të Elezit dhe AMF-së në fshatin Gorancë	10,000.00	15,000.00	25,000.00	50,000.00
30	Pajisje me gjenerator në QKMF - Hani i Elezit	20,000.00	-	-	20,000.00
920	Arsimi dhe Shkenca	55,000.00	170,000.00	175,000.00	400,000.00
92175	Administrata	55,000.00	170,000.00	175,000.00	400,000.00
31	Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML - Dardania, SHFMU - Ilaz Thaçi, SHFMU - Kështjella e Diturisë dhe SHMFU - Veli Ballazhi, Institucioni Parashkollor "Ardhmëria"	55,000.00	60,000.00	55,000.00	170,000.00
32	Ndërtimi i objektit të SHFMU në Lagjen e Re	-	50,000.00	50,000.00	100,000.00
33	Ndërtimi i çerdhes në Lagjen e Re	-	60,000.00	70,000.00	130,000.00
850	Kulturë, Rini dhe Sport	30,000.00	40,000.00	50,000.00	120,000.00
85035	Shërbimet Kulturore	30,000.00	40,000.00	50,000.00	120,000.00
34	Rikonstruksionimi i stadiumit "Suad Brava"	-	15,000.00	20,000.00	35,000.00
35	Pajisja me gjenerator në Qendrën Kulturore "Imri Curri"	20,000.00	-	-	20,000.00
36	Renovimi i sallave sportive në shkollat: SHFMU "Ilaz Thaçi", SHFMU "Veli Ballazhi" dhe "Kështjella e Diturisë"	10,000.00	25,000.00	30,000.00	65,000.00

Projeksioni i të Hyrave Vetanake për vitet 2026-2028

Nr	Përshkrimi	Viti 2025	Planifikimi 2026	Vlerësimi 2027	Vlerësimi 2028
A	B	C	D	E	F
1	TË HYRAT KOMUNALE TOTALE	3,615,457.00	4,234,682.00	4,457,136.00	4,672,491.00
1.1	TË HYRAT VETANAKE	339,719.00	356,720.00	383,895.00	385,721.00
1.1.1	Tatimi në pronë	135,908.00	149,145.00	159,958.00	161,558.00
1.1.2	Tatimi në tokë	31,970.00	37,392.00	45,245.00	45,471.00
1.1.3	Taksat Komunale	144,841.00	143,183.00	147,360.00	146,039.00
	<i>Licencat dhe lejet</i>	5,841.00	5,800.00	5,600.00	5,039.00
	<i>Certifikatat dhe dokumentet zyrtare</i>	8,000.00	8,000.00	8,000.00	8,000.00
	<i>Taksat e pajisjeve motorike</i>	21,000.00	20,000.00	21,560.00	21,000.00
	<i>Lejet per ndërtesa</i>	25,000.00	24,383.00	25,200.00	25,000.00
	<i>Taksat tjera komunale</i>	85,000.00	85,000.00	87,000.00	87,000.00
1.1.4	Ngarkesat Komunale	27,000.00	27,000.00	31,332.00	32,653.00
	<i>Të hyrat nga qiraja</i>	3,000.00	3,000.00	4,000.00	4,500.00
	<i>Bashkë-pagesat për arsim</i>	15,000.00	15,000.00	16,000.00	16,500.00
	<i>Bashkë-pagesat për shëndetësi</i>	9,000.00	9,000.00	11,332.00	11,653.00
	<i>Ngarkesat rregullatore</i>	-	-	-	-
	<i>Ngarkesat tjera komunale</i>	-	-	-	-
1.1.5	Të hyrat tjera (gjobat)	-	-	-	-
1.2	TRANSFERET QE VERITARE	3,275,738.00	3,877,962.00	4,073,241.00	4,286,770.00
1.2.1	Granti i përgjithshëm	1,701,892.00	1,872,179.00	2,007,285.00	2,158,835.00
1.2.2	Granti për Arsim	1,167,634.00	1,429,646.00	1,472,535.00	1,516,712.00
1.2.3	Granti për Shëndetësi	406,212.00	576,137.00	593,421.00	611,223.00

ANEKS 1

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjijnor

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse
Komuna Hani i Elezit

Viti	Numri total i stafit	Numri totali stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2023	249	103	128	595,647	1,107,175
2024	249	119	130	816,800	1,225,200
2025	260	119	130	920,000	1,252,712
Planifikimi për 2026	280	137	143	1,200,000.00	1,289,562

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2025- Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore
Komuna Hani i Elezit

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel.	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
401-600					
600+					

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)
Komuna Hani i Elezit

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve gra	Numri i përfituesve burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2023	100,000	70	7,900	23,200	50,000	50,000
2024	113,000	350	175	175	56,500	56,500
2025	143,000	350	175	175	71,500	71,500
Planifikimi për 2026	185,000	350	175	175	92,500	92,500

Sqarim: Numri i përfituesve dhe shumat nuk janë definitive për vitin 2025 pasi që ende nuk është shpenzuar totalisht kategoria e Subvencioneve.



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 7465 2025

DATA :	09.09.2025
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Kërkesë për rritjen e buxhetit të Komunës Hani i Elezit nga tejkalimi i projeksonit të të hyrave vetanake për vitin 2025

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar/a Anëtarë/e të Kuvendit Komunal,

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, neni 2, paragrafi 2.3 dhe në bazë të nenit 6, paragrafi 2 i Ligjit 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe duke u bazuar në tejkalimin e projeksonit të të hyrave vetanake të vitit fiskal 2025, kërkojmë nga ana e juaj të aprovoni kërkesën tonë për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i projeksonit të të hyrave vetanake në kuadër të Nën-Programeve dhe kategorive buxhetore. Projeksoni i të hyrave vetanake për vitin 2025, është në shumë prej 339,719.00 €. Komuna Hani i Elezit ka tejkualuar këtë projekson, gjegjësisht prej muajit janar deri më datë 31.08.2025 ka inkasuar prej të hyrave direkte dhe indirekte në shumë prej 1,146,193.72 €. Përmbushja e planifikimit buxhetor me financim nga Të Hyrat Vetanake është realizuar në shumë prej 339,719.00 €. Shuma prej 759,225.32 € është alokuar nëpër Nën-Programe dhe kategori buxhetore, të paraqitura në Vendimin e Kuvendit Komunal të datës 26.06.2025 me Nr.01/4495/2025.

Andaj, pjesën tjetër të të hyrave të inkasuara nga data 06.06.2025 deri më 31.08.2025 në shumë prej 47,249.40 €, kërkojmë nga ana e juaj të aprovoni këtë kërkesë për t'i orientuar apo alokuar në Nën-Programe dhe kategori buxhetore, të paraqitura në shkresën përcjellëse.

Me respekt,

1. Në kuadër të kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere në shumë prej **27,000.00** €, në këto Nën-Programe Buxhetore:
 - Zyra e Kryetarit (16035), kodi funksional (0111) në shumë prej 20,000.00 €.
 - Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve (18444), kodi funksional (0320), në shumë prej 3,000.00 €
 - Pylltaria dhe inspeksioni (47115), kodi funksional (0422), në shumë prej 4,000.00 €.

2. Në kuadër të kategorisë buxhetore Shpenzime Kapitale, në shumë prej **20,249.40** €, në këtë Nën-Program Buxhetor:
 - Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej 20,249.40.00 € në këtë projekt:
“Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimcës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri - Oborri i Komunës, Stadiumi i qytetit - Suad Brava,- Shpronsim (56230), në shumë prej 20,249.40 €.



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.7488/2025

DATA:	09.09.2025
PËR:	Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës.
NGA:	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Florim Shkreta
LËNDA:	Shkresë përcjellës: Propozim vendim për planin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2026.

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim propozim vendimin për planin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2026.

Me respekt



01/ Nr. ____/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë ...09.2025 merr:

PROPOZIM VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2026

1. Kuvendi i komunës miratoi propozim vendimin për planin e punës së kuvendit të komunës së Hani të Elezit për vitin 2026.
2. Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit për vitin 2026 planifikon t'i mbajë gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe çdo mbledhje të kuvendit i paraprin mbledhja e komitetit për politik dhe financa.
3. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Hani të Elezit, do të mbahen sipas periudhës kohore të paraqitura si në tabelë:

	Vendimet/Çështjet
JANAR 2026	• Raporti financiar për vitin 2025. • Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025-2026. • Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2026. • Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2025.
SHKURT 2026	• Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2025. • Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2025. • Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual. • Raporti financiar për vitin 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a. • Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
MARS 2026	• Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2025. • Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025. • Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hani të Elezit për vitin 2025.
PRILL 2026	• Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026. • Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit . • Informatë për ndarjen e bursave. • Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

MAJ 2026	• Rishikimi i buxhetit të komunës për vitin 2026. • Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
QERSHOR 2026	• Korniza afatmesme buxhetore 2027-2029. • Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027.
KORRIK 2026	• Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2026. • Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2025. • Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2025. • Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2026. • Raporti për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2025. • Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2026 i N.P.L “Pastrimi” sh.a. • Informatë për sektorin e emergjencave.
GUSHT 2026	• Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2026. • Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2025-2026. • Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2027. • Informatë për korrje shirjet.
SHTATOR 2026	• Buxheti i komunës për vitin 2027 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2028-2029. • Miratimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2027. • Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2027. • Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2027/2028.
TETOR 2026	• Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2026. • Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2027. • Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2027. • Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit . • Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2026 i N.P.L Pastrimi sh.a. • Informatë për çështjen e ujit. • Informatë për qendrën për punë sociale.
NËNTOR 2026	• Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi. • Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.
DHJETOR 2026	• Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2027. • Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2027 • Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2027.

4. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2026, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.
5. Të gjitha mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të jenë të hapura për qytetarë dhe përfaqësues të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësues të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.
6. Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten.
7. Njoftimet për mbledhje të kuvendit të komunës bëhen publike. Materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
8. Plani i mbledhjeve të kuvendit, i përcaktuar si në pikën tre (3) të këtij vendimi, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.
9. Plani i mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2026, ka fuqi veprimi nga muaji Janar deri në muajin Dhjetorë të vitit 2026.
10. Ky propozim vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë propozim vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: ...09.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



Nr. 05/ 7496/2025

DATA	09.09.2025
PËR	KPF DHE KUVENDIN E KOMUNËS
NGA	Hisni Luri Drejtoria për Arsim,
Lënda	Informatë për fillimin e vitit shkollor 2025/2026

Të nderuar:

Po ju përcjellim informatën për fillimin e vitit shkollor 2025/2026

Me respekt,

DREJTORIA PËR ARSIM

I N F O R M A T Ë

Për fillimin e vitit shkollor 2025/2026

Viti shkollor 2025/2026 në Komunën e Hanit të Elezit ka filluar sipas datës së përcaktuar në kalendarin e MAShT-it. Janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit shkollor, përfshirë pastrimin gjeneral të objekteve shkollore.

Nxënësit e shkollave fillore janë pajisur me libra përmes subvencioneve të aplikuara nga prindërit në platformën e-Kosova, e cila ka pasur disa vështirësi teknike gjatë aplikimit. Për këtë arsye, në secilën shkollë është caktuar një koordinator përgjegjës për klasat I-V dhe një tjetër për klasat VI-IX, të cilët kanë ndihmuar MAShT-in në procesin e verifikimit të numrit të nxënësve për subvencionimin e librave në Komunën tonë.

Në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit shkollor 2025/2026, gjatë muajit gusht është realizuar pranimi i kuadrit arsimor për plotësimin e vendeve të lira, të raportuara nga drejtorët e shkollave dhe DKA. Gjithsej në nivel komunal kanë qenë 5 vende të lira për plotësim:

- 1 mësimdhënës i Matematikës në SHML “Dardania”,
- 1 mësimdhënës i Matematikës në ShFMU “Veli Ballazhi”,
- 1 zëvendësim për arsim fillor,
- 1 zëvendësim për Gjuhë Shqipe,
- 1 mësimdhënës i Fizikës në ShFMU “Ilaz Thaçi” – Hani i Elezit.

Sistemi arsimor në Komunë është i organizuar në katër nivele:

- Niveli 0: Arsimi parashkollor (mosha 5–6 vjeç),
- Niveli 1: Arsimi fillor (nga mosha 6 vjeç),
- Niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët (nga mosha 12 vjeç),
- Niveli 3: Arsimi i mesëm i lartë (nga mosha 15 vjeç).

Në Komunën e Hanit të Elezit funksionojnë:

3 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta:

- ShFMU “Ilaz Thaçi” – Hani i Elezit (me paralelen fizike në fshatin Seçishtë),
- ShFMU “Kështjella e Diturisë” – Paldenicë,
- ShFMU “Veli Ballazhi” – Gorancë.

1 shkollë e mesme e lartë:

- SHML “Dardania” – Hani i Elezit.

Numri i nxënësve në fillim të vitit shkollor 2025/2026

- Numri i nxënësve Parafillor në nivel Komunal gjithsejtë janë 99 nxënës.
- Numri i nxënësve nga klasa e I-V në nivel Komunal gjithsejtë janë 615 nxënës.
- Numri i nxënësve nga klasa e VI-IX në nivel Komunal gjithsejtë janë 533 nxënës. Numri i nxënësve nga Parafillor deri te klasa e -IX në nivel Komunal gjithsejtë janë 1247 nxënës.

Numri i nxënësve nga klasa e X-XII në nivel Komunal gjithsejtë janë 270 nxënës.

Numri i nxënësve nga Parafillor deri në klasën e dymbëdhjetë në nivel Komunal gjithsejtë janë 1517 nxënës.

Krahasimi i nxënësve mes vitit shkollor 2024/25 dhe 2025/26 në nivelin komunal për të gjitha shkollat e Komunës

2024/2025	1570
2025/2026	1517
Krahasimi i nr.të nxënësve	-53

Insuticioni Parashkollor “ Ardhmëria” Hani i Elezit

- Numri i fëmijëve Parafillor- Çerdhe është 54 fëmijë 31 M dhe 23 F.
- Krahasimi me vitin shkollor 2024-2025, kemi 1 fëmijë më shumë
- Viti shkollor 2024-2025, 53 fëmijë
- Viti shkollor 2025-2026, 54 fëmijë

ShFMU "Ilaz Thaçi"-Hani i Elezit.

- Numri i nxënësve Parafillor është 69 nxënës 39 M dhe 30 F.
- Numri i nxënësve nga klasa e I-V janë 454 nxënës 238 M dhe 216 F.
- Numri i nxënësve nga klasa e VI-IX janë 411 nxënës 210 M dhe 201 F.
- Numri i nxënësve nga klasa I – IX janë 865 nxënës 448 M dhe 417 F

Numri i nxënësve nga Parafillor deri në klasëne nëntë është 934 nxënës 487 M 447 F

Krahasimi me vitin shkollor 2024 -2025, kemi 48 nxënës më pakë

Viti shkollor 2024-2025, 982 nxënës

Viti shkollor 2025-2026, 934 nxënës

ShFMU "Kështjella e Diturisë"-Paldenicë.

Numri i nxënësve Parafillor është 21 nxënës 12 M dhe 9 F.

Numri i nxënësve nga klasa e I-V janë 98 nxënës 50 M dhe 48 F.

Numri i nxënësve nga klasa e VI-IX janë 64 nxënës 34 M dhe 30 F.

Numri i nxënësve nga klasa I – IX janë 162 nxënës 84 M dhe 78 F

Numri i nxënësve nga Parafillor (0) deri në klasën e nëntë(9) është 183 nxënës 96 M dhe 87 F

Krahasimi me vitin shkollor 2024-2025 kemi 2 nxënës më shumë .

Viti shkollor 2024-2025, 181 nxënës 93 M dhe 88 F

Viti shkollor 2025-2026, 183 nxënës 96 M dhe 87 F

Numri i nxënësve nga Parafillorë deri në klasëne nëntë është 183 nx.

Sh.F.M.U. "Veli Ballazhi"-Gorancë.

- Numri i nxënësve Parafillor janë 9 nxënës parafillor.8 M 1 F
- Numri i nxënësve nga klasa e I-V janë 63 nxënës 29 M dhe 34 F.
- Numri i nxënësve nga klasa e VI-IX janë 58 nxënës 31 M dhe 27 F
- Krahasimi me vitinshkollor 2025-2026 kemi 9 nxënës më pakë 79 M dhe 41 F.
- Viti shkollor 2024-2025 129 nxënës 79 M dhe 41F
- Viti shkollor 2025-2026, 121 nxënës 60 M dhe 61F

Numri i nxënësve nga Parafillorë deri në klasëne nëntë është 130 nx.

NUMRI I NXËNËSVE NË FILLIM Të VITIT SHKOLLOR 2025/2026															
Niveli Parafillor 1-5 6-9 10-12	SHKOLLAT														
	SHFMU "Ilaz Thaçi"			SHFMU "K. e Diturisë"			SHFMU "Veli Ballazhi"			SHML "Dardania"		Gjithsejt			
	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ
Parafillor	39	30	69	12	9	21	1	8	9				52	47	99
Klasa 1	45	48	93	10	8	18	3	5	8				58	61	119
Klasa 2	47	37	84	11	10	21	3	8	11				61	55	116
Klasa 3	43	38	81	9	10	19	7	7	14				59	55	114
Klasa 4	50	44	94	10	11	21	9	6	15				69	61	130
Klasa 5	53	49	102	10	9	19	7	8	15				70	66	136
Klasa 6	59	59	118	12	9	21	11	7	18				82	75	157
Klasa 7	45	50	95	5	6	11	6	9	15				56	65	121
Klasa 8	51	47	98	11	9	20	5	5	10				67	61	128
Klasa 9	55	45	100	6	6	12	9	6	15				70	57	127
Klasa 10										45	43	88	45	43	88
Klasa 11										36	43	79	36	43	79
Klasa 12										53	50	103	53	50	103
Gjithsejtë	487	447	934	96	87	183	61	69	130	134	136	270	778	739	1517

NUMRI I NXËNËSVE NË FILLIM Të VITIT SHKOLLOR 2025/2026									
Niveli Parafillor 1-5 6-9	SHKOLLAT								
	SHFMU "Ilaz Thaçi"			SHFMU "Ilaz Thaçi" Paralelja- Seçishtë			Gjithsejt		
	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ
Parafillor	34	24	58	5	6	11	39	30	69
Klasa 1	40	44	84	5	4	9	45	48	93
Klasa 2	45	35	80	2	2	4	47	37	84
Klasa 3	38	37	75	5	1	6	43	38	81
Klasa 4	43	38	81	7	6	13	50	44	94
Klasa 5	45	42	87	8	7	15	53	49	102
Klasa 6	59	59	118				59	59	118
Klasa 7	45	50	95				45	50	95
Klasa 8	51	47	98				51	47	98
Klasa 9	55	45	100				55	45	100
Gjithsejt	455	421	876	32	26	58	487	447	934

NUMRI I NXËNËSVE NË FILLIM TË VITIT SHKOLLOR 2025/2026

Krahasimi	SHKOLLAT														
	SHFMU "Ilaz Thaçi"			SHFMU "K. e Diturisë"			SHFMU "Veli Ballazhi"			SHML "Dardania"			Gjithsejt		
	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ	M	F	GJ
2024/2025	513	469	982	93	88	181	76	53	129	130	148	278	812	758	1570
2024/2025	487	447	934	96	87	183	61	69	130	134	136	270	778	739	1517
Krahasimi	-26	-22	-48	3	1	2	+15	-16	-1	-4	-12	-8	-34	+19	-53

SH.M.L."Dardania"- Hani i Elezit

Përgatitjet janë bërë që mësimi të fillon sipas kalendarit shkollor më 01.09.2025, ka filluar mësimin sipas kalendarit shkollor të caktuar nga Masht-i

Janë bërë përgatitjet teknike si dhe pastrimi higjienik dhe dezenfektimi i tërë shkollës

Numri i nxënësve mund të ndryshojë sepse janë pranuar nxënësit që kanë perseritur vitin dhe te cilit nuk kanë aplikuar sipas afateve për regjitrin në afatin e muajit: qershor dhe gusht.

Numri i nxënësve në kl-e X-ta është 88 nxënës

Numri i nxënësve në kl- e XI-ta është 79 nxënës

Numri i nxënësve në kl- e XII-ta është 103 nxënës

Gjithsej nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor në klasë të dhjeta janë 88 nx

Krahasimi me vitin shkollor 2024-2025 kemi 8 nxënës më pakë për vitin 2025/2026

Viti shkollor 2024-2025, 278 nxënës prej tyre 130 M dhe 148 F

Viti shkollor 2025-2026, 270 nxënës prej tyre 134 M dhe 136 F

Data: 09.09.2025

Hani i Elezit

Drejtori i Arsimit

Hisni Luri



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
KOMUNA HANI I ELEZIT

DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Nr.06/2025

DATE:	16.09.2025
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi – Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA:	Nexhmedin Daci– Drejtor për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
TEMA:	Propozim vendim për rishqyrtim të aktit normativ

Të nderuar:

Përmes kësaj shkrese i drejtohem Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendit Komunal, të bëjë rishqyrtimin e ligjmërisë së aktit respektivisht vendimit nr.01/Nr.6023/2025 për miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës Hani i Elezit 2025-2033 miratuar nga Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.21.08.2025.

Bashkëlidhur me shkresën keni:

-Shkresën nga MMPH dhe MAPL të dt.16.09.2025 6528-2/25 për rishqyrtimin e ligjmërisë së aktit në fjalë, si dhe

-Propozim vendimin e korigjuar për miratim të Planit Zhvillimor të Komunës Hani i Elezit 2025-2033.

Me respekt



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
KOMUNA HANI I ELEZIT



01/Nr.6023/2025

Bazuar në nenin 12 shkronja d dhe neni 17 paragrafi 1 shkronja b e Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28\2002, e në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, neni 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, neni 10 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 dhe nenet 11 dhe 15 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Udhëzimit Administrative (MMPH) nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimit Administrativ (MMPH) nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, Vendimit për dhënjën e pëlqimit për miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës Hani i Elezit 2025-2033 me nr. 4351-2/25 të dt.31.07.2025 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe neni 76 pika a të statutit të Komunës Hani i Elezit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 21.08.2025, merrë këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS HANI I ELEZIT 2025-2033

Neni 1

Miratohet Plani Zhvillimor Komunal i Komunës Hani i Elezit për periudhën kohore 2025-2033, si dokument themelor i planifikimit hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik të Komunës.

Neni 2

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) është plan strategjik multi sektorial i cili percakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik social dhe hapësinor të komunës Hani i Elezit dhe si i tillë përfshinë planin për zhvillimin e gjitha zonave urbane dhe rurale për një periudhë kohore 8 vjeqare.

Neni 3

Plani Zhvillimor Komunal është hartuar në pajtim me Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, dokumentet strategjike sektoriale, dhe rekomandimet e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Ky Plan do të shërbejë si bazë për hartimin dhe miratimin e dokumenteve tjera të planifikimit hapësinor dhe zhvillimit komunal.

Neni 5

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit të Komunës Hani i Elezit.

Neni 6

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Hanit të Elezit.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Plani ekzistues Zhvillimor i Komunës 2010-2025+.

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,
- Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit si dhe
- Arkivit të Komunës.

21.08.2025

Hani i Elezit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Florim Shkreta





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLICA OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Në: / No: 6528-2/25
Org./Unit: AL
Titull / Title: Hyrëse / Incoming
Duke / Date: 16.09.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data / Datum: 16.09.2025
Date:

Nësimi organizativ	Nr. i Lendës	Vlera
-V1-020-530/3		

Për:	Mehmet Ballazhi, Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit Florim Shkreta, Kryesues e Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Hysen Durmishi, U.D Ministër në Detyrë në MMPHI Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Shendrita Latifi - Zyrtare Ligjore në Divizionin për 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Mbështetjes Ligjore
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi 0/ Nr.6023/2025 për miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës Hani i Elezit 2025-2033, miratuar nga Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit, datë 21.09.2025

I nderuar kryetar Ballazhi,
I nderuar kryesues Shkreta

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 01.09.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 0/ Nr.6023/2025 për miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës Hani i Elezit 2025-2033, miratuar nga Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit, datë 21.09.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimin 0/ Nr.6023/2025 për miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës Hani i Elezit 2025-2033, miratuar nga Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit, datë 21.09.2025.

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Në këtë Vendim duhet të korrigjohet neni 3, ku ndër të tjera përmendet "...dhe rekomandimet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës...", pasi kjo është në kundërshtim me Ligjin për Planifikimin Hapësinor.

MMPHI nuk jep "rekomandime", por sipas Ligjit kërkon plotësime dhe ndryshime në përputhje me dispozitat ligjore që autoritetet përgjegjëse lokale për planifikim dhe menaxhim hapësinor duhet t'i përmbushin për miratimin e dokumentit të planifikimit hapësinor.

Në Vendim duhet të shtohet një nen shtesë, në të cilin të specifikohet qartë cilin dokument e shfuqizon "Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033".

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

